



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

**PËRMBARUES PRIVAT AFET MJEKU-** adresa; Uçk-së, Nr.46, Kat II -Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit 71046281 dhe numër fiskal 601095830 e përfaqësuar nga Afet Mjeku, ("Kontraktuesi"), janë pajtuar te lidhin këtë kontrate publike për punët e shënuara me poshtë

### Angazhimi i përbartuesve privat për inkasimin e gjobave komunale

Nr1 i prokurimit	616-18-2482-2-2-1
Nr i brendshëm	616 18 052 221

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Angazhimin i përbartuesve privat për inkasimin e gjobave komunale**.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofriuci i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendorur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit në afat prej 12 muajsh.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## **Neni 2            Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i cekur ne planin e menagjimit të dakorduar nga të dy palët.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtinë.

## **Neni 3            Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është [20,000.00] Euro(Njëzet mijë euro e zero zero eurocent). Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Pagesa do te behen per cdo muaj per muajin paraprak me konstatim nga menaxheri dhe organi mbikëqyrës i projektit.

## **Neni 4            Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 5            Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë

në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsyé.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhen **Shqipë** në tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
<b>Drejtori I Prokurimit</b>			
Emri:	<b>Zekë Bardhaj</b>	Emri:	<i>AJET HJEKU</i>
Pozita:	<b>Udhëheqës i Prokurimit</b>	Pozita:	<i>PËRMBARUES PRIVAT</i>
Nënsh.		Nënsh.	
Data:	<b>25.06.2018</b>	Data:	<b>25.06.2018</b>
Vula:		Vula:	

## PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Shërbimet**" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "**Ofrues i shërbimeve**" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "**Personeli**" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nënkontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "**Çmimi i kontratës**" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "**Nënkontraktuesi**" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "**Palë**" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "**Palët**" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "**Autoriteti Kontraktues**" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.

1.9 "**KPK**" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "**KVK**" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve

për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjën ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve përvendimin e vet brenda 30 ditës pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përm bushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofreusit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofreusin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### **Neni 8 Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë

të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuan me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë konratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgogjeluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga

Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së konratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humjet që i janë shkaktuar nën kushtet e konratës.

## Neni 10

### Ndërprerja e Konratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas konratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## Neni 11

### Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas konratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përmes fushëveprimit të konratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të konratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me konratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të konratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të konratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e konratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas konratës.

Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitetë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12      Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13      Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për

kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### **Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### **Neni15      Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## Neni 16

### Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

## Neni 17

### Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

#### **Neni 18 Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19 Konsekuenca e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpérblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoresh, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

**PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizoterojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i Nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 12 MUAJ
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Prishtine
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit CAKTOHET NGA ZKA
Siguria e ekzekutimit	14.1	n/a
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	n/a
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Tarifat për administrimin e lëndës si dhe tarifat për veprimet e ndërmarrura të parapara në do t'i paguhen përmbaruesit privat, nga kreditori para realizimit të aktivitetit të përmbaruesit, për t'u rimbursuar pastaj nga debitori. Tarifen e përfomancës e cila varet nga efikasiteti i zbatimit të përmbarimit, përmbaruesi privat do ta arkëtoj nga debitori pas kryerjes së veprimit përmbarimor.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Përmbaruesi privat duhet të mbajë <b>evidence për rastet e pranuara</b> dhe ato të përfunduara. Evidenca do ti dorëzohet KK Prishtinës sipas kërkesës. Evidenca duhet te përfshij të dhënat si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ emrin e Gjykatës e cila përdheron përmbarimin ose sigurimin e kërkesës;</li> <li>○ numrin e lëndës përmbarimore;</li> <li>○ numrin e objektit të përmbarimit apo objektin në bazë të cilit sigurohet kërkesa;</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>○ të dhënat për kreditorin dhe debitorin të cilat janë të deklaruara në aktvendimin për përbarim;</li> <li>○ data e pranimit të kërkesës për përbarim dhe për mbledhjen e borxhit;</li> <li>○ data e vendimit për caktimin në detyrë të përbaruesit privat dhe data e pranimit të këtij vendimi;</li> <li>○ objekti dhe mjeti i përbarimit nëse të dhënat e tilla mundën të gjinden në aktvendimin për përbarim;</li> <li>○ shuma që kërkohet;</li> <li>○ vendimet të cilat i merri gjatë përbarimit;</li> <li>○ shuma e borxhit të mbledhur;</li> <li>○ koha dhe rezultati i përbarimit të kryer;</li> <li>○ të dhënat për personat nga të cilat janë mbledhur borxhet dhe shuma e borxhit të mbledhur;</li> <li>○ shuma përfundimtare e shpërbimit dhe kompensimit të shpenzimeve nga përbaruesi privat;</li> <li>○ numri i përgjithshëm i lëndëve në nivelin vjetor, në të cilat përbaruesi privat ka vepruar.</li> </ul>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëves hjes	20.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëves hjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përherershëm i Arbitrazhit të Kosovës</b> në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përményrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

## SHËNIM

Pjesa C: - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

## **PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT**

### **Pjesa I. Formulari i Tenderit**

Për: Komuna e Prishtines

(në vazhdim të tekstit “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i kontratës: **Angazhimi i përmbaruesve privat për inkasimin e gjobave komunale**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: 616 18 052 221 >. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

3. Çmimi total i tenderit është:

[Nëse objekti i kontratës nuk është i ndarë në pjesë]

Çmimi i tenderit në shifra: [40.00 €]

Dhe në fjale [katerdhjetë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej [60 diteve] nga data finale për dorëzim të tendereve.

5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës [n/a].

6. Operatori Ekonomik [dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: [shëno nacionalitetin]

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet], me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjeter. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secillin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshire edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës

[Në rast të konsorciumit]


[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjeter. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secillin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshire edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës

së realizimit të kontratës].

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të finançuara nga BKK.

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrimet ndaj nesh nëse e bën këtë.

#### E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANIËS	PËRMBARUES PRIVAT AFET MJEKU
ADRESA E PLOTE	RR. "UÇK" NR. 46 KATI II, PRISHTINË
<b>PËRFAQËSUAR NGA:</b>	
EMRI & MBIEMRI	AFET MJEKU
POZITA	PËRMBARUES PRIVAT
NËNSHKRIMI	
DATA	11.05.2018
VULA	



#### [Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1*		
Etj... *		

\* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit:  
[shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]


Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën]

Vula e Udhëheqësit: \_\_\_\_\_

**LISTA E CMMIVEVE**

<b>Tabela 1</b>		<b>Tarifa për administrimin e lendes ne euro (60% i pikave per vleresim)</b>
<b>Nr.</b>	<b>Vlera e përbartimit në euro</b>	
1	Deri 50 euro	5.00
2	Nga 51 deri 100	6.00
3	Nga 101 deri 300	7.00
4	Nga 301 deri 500	8.00
5	Nga 301 deri 500	X.00
6	Nga 501 deri 1000	X.00
7	Nga 1001 deri 2 000	X.00
8	Nga 2001 deri 3 000	X.00
9	Nga 4001 deri 5 000	X.00
10	Nga 5001 deri 7 000	X.00
11	Nga 7001 deri 9 000	X.00
12	Nga 9001 deri 11 000	X.00
13	Nga 11001 deri 15 000	X.00
14	Nga 15 001 deri 25 000	X.00
15	Nga 25 001 deri 40 000	X.00
16	Nga 40 001 deri 60 000	X.00
17	Nga 60 001 deri 100 000	X.00
18	Nga 100 001 deri 200 000	X.00
19	Mbi shumën 200 000	X.00
<b>A - Gjithesejt (1-19)</b>		<b>50.00</b>

**Tabela 2**




Nr.	Veprimi i ndërmarrë	SHUMA (40% i pikeve per vleresim)
1	Kopjimi plotësues i shkresave për faqe	0.00
2	Shkuaria deri te vendi i përbarimit, por jo me transport nga palet, nëse vendi është më larg se 5 km nga selia e përbaruesit privat për çdo km	0.00
3	Prokurimi i të dhënave për pasurinë e debitorit për kërkësë	0.00
4	Prokurimi i të dhënave për pasurinë e debitorit për te gjitha kërkësat	0.00
5	Prokurimi i të dhënave nga organi kompetent për identitetin dhe adresën e debitorit	0.00
6	Prokurimi i ekstraktit nga regjistri publik, të certifikatës ose kopjes nga gjykata apo organi tjeter	0.00
7	Dërgimi i shkresave të cilat dalin në kuadër të punës së përbaruesit privat, rastet kur dorëzimin e kryen përbaruesi privat për dërgesë	5.00
8	Dorëzimi i shkresave gjyqësore dhe shkresave të organeve të tjera administrative dhe të institucioneve publike për dërgesë	0.00
9	Përpilimi i propozimit për zbatimin e përbarimit dhe të propozimeve tjera, urdhrit për përbarim dhe konkluzionit	20.00
10	Përpilimi i kërkësës	0.00
11	Përpilimi i procesverbalit	0.00
12	Përpilimi i përgjigjës në kundërshtim	0.00
13	Përpilimi i shënimit zyrtar	0.00
14	Pjesëmarria në shijen publike dhe ndërmarrja e vepprimeve të zbatimit të përbarimit jashtë zyrës për çdo orë të filluar	0.00
15	Shikimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme	0.00
16	Pjesëmarria në seancën gjyqësore lidhur me kërkësen për evitimin e parregullsive nëse kërkesa është refuzuar	0.00
17	Lëshimi i vërtetimeve dhe certifikatave nga lënda në të cilën vepron përbaruesi privat për kërkësë	0.00
18		



19	Taksa gjyqësore dhe administrative	0.00
20	Shpenzimet reale të krijuara me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbartuese	0.00
21	Kryerja e veprimeve në pajtim me nenin 282-289 të LPP-se për orën e parë	0.00
22	Kryerja e veprimeve në pajtim me nenin 282-289 të LPP-se për cdo ore shtese pas kalimit te ores fillostare	0.00
<b>B - Gjithesjet (1-22)</b>		<b>25.00</b>

Tabelia 3

Nr.	Vlera e përbartimit në euro	Tarifa përfeksionit e zbatimit të përbartimit në euro
1	Deri 50 euro	15
2	Nga 51 deri 100	20
3	Nga 101 deri 300	30
4	Nga 301 deri 500	50
5	Nga 301 deri 500	60
6	Nga 501 deri 1000	15%
7	Nga 1001 deri 2 000	13%
8	Nga 2 001 deri 3 000	11.50%
9	Nga 4 001 deri 5 000	10%
10	Nga 5 001 deri 7 000	8.50%
11	Nga 7 001 deri 9 000	7%
12	Nga 9 001 deri 11 000	5.50%
13	Nga 11 001 deri 15 000	5%
14	Nga 15 001 deri 25 000	4%
15	Nga 25 001 deri 40 000	3.20%
16	Nga 40 001 deri 60 000	2.50%
17	Nga 60 001 deri 100 000	2%
18	Nga 100 001 deri 200 000	1.60%



	çmimi total	çmimi total i peshuar
A - Gjithsej (1-19):	50.00	30.00
B - gjithsejt (1-22):	25.00	10.00

**Çmimi i Total i peshuar (ofertat do te vleresohej ne baze te kesaj vlera).  
Kjo eshte vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe  
do te lexohet gjate hapjes publike**

40.00

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) PËRMBARUES PRIVAT AFET MJEKU	
Emri i OE:	AFET MJEKU
Emri dhe mbiemri i perfaqesuesit te OE:	↓ ↓ ↓
Nenshkrimi:	OVES
Data:	11.05.2018
Vula:	

